



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**USTAVNI SUD**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

---

Prishtinë, më 1 korrik 2024  
Nr. ref.: RK 2458/24

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**rastin nr. KI192/22**

Parashtrues

**Elire Krasniqi**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit  
të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 51/21, të 10 marsit 2022**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar  
Enver Peci, gjyqtar dhe  
Jeton Bytyqi, gjyqtar

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është dorëzuar nga Elire Krasniqi (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesja e kërkesës) nga Komuna e Prishtinës, e përfaqësuar nga Armend Krasniqi, avokat.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesja e kërkesës e konteston Aktgjykimin [Rev. nr. 51/21] e 10 marsit 2022 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) në lidhje me Aktgjykimin [Ac. nr. 1667/19] e 11 gushtit 2020 të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) dhe Aktgjykimin [C. nr. 47/2015] të 12 qershorit 2017 të Gjykatës Themelore në Prizren (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).
3. Parashtruesja e kërkesës Aktgjykimin e kontestuar e ka pranuar më 23 shtator 2022.

## **Objekti i çështjes**

4. Objekt i çështjes së kërkesës është shqyrtimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, me të cilin pretendohet të jenë shkelur të drejtat e parashtrueses së kërkesës, të garantuara me nenet 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6.1 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).
5. Parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjykata që identiteti i saj të mos zbulohet.

## **Baza juridike**

6. Kërkesa bazohet në paragrafin 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 25 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
7. Më 7 korrik 2023, Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 01/2023, u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe hyri në fuqi 15 ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata Kushtetuese i referohet dispozitave të Rregullores së lartcekur. Lidhur me këtë, konform rregullit 78 (Dispozitat kalimtare) të Rregullores së punës Nr. 01/2023, përjashtimisht, dispozita të caktuara të Rregullores së punës Nr. 01/2018, do të vazhdojnë të zbatohen në lëndët e regjistruara në Gjykatë para shfuqizimit të saj, vetëm nëse dhe për aq sa janë më të favorshme për palët.

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

8. Më 9 dhjetor 2022, parashtruesja e kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
9. Më 16 dhjetor 2022, gjyqtari Enver Peci dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç' rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
10. Më 20 dhjetor 2022, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit [nr. GJR. KI192/22] e caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci gjyqtare raportuese dhe përmes Vendimit [nr. KSH. KI192/22] e caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani, (kryesuese), Radomir Laban dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).

11. Më 27 dhjetor 2022, Gjykata e njoftoi parashtruesen e kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Në të njëjtën ditë, një kopje të kërkesës ia dërgoi Gjykatës Supreme.
12. Më 24 prill 2023, Gjykata kërkoi nga parashtruesja e kërkesës që të dorëzojë autorizimin për përfaqësim para Gjykatës brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh.
13. Më 24 prill 2023, Gjykata njoftoi Gjykatën Themelore për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi që të dorëzojë fletëkthesën me informata se kur e ka pranuar parashtruesja e kërkesës vendimin e kontestuar.
14. Më 4 maj 2023, Gjykata Themelore dorëzoi në Gjykatë fletëkthesën që dëshmon se parashtruesja e kërkesës ka pranuar Aktgjykimin e kontestuar më 23 shtator 2022.
15. Më 30 maj 2023, Gjykata kërkoi përsëri nga parashtruesja që të dorëzojë autorizimin për përfaqësim brenda afatit prej shtatë (7) ditësh.
16. Më 9 qershor 2023, parashtruesja e kërkesës dorëzoi në Gjykatë autorizimin e kërkuar.
17. Më 14 nëntor 2023, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe vendosi që rasti të shtyhet për shqyrtim në një nga seancat e radhës, me kërkesë që i njëjti të plotësohet.
18. Më 11 mars 2024, gjyqtari Jeton Bytyqi dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç' rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
19. Më 28 maj 2024, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

### **Përmbledhja e fakteve**

20. Më 9 nëntor 2012, parashtruesja e kërkesës kishte pësuar lëndime në një aksident komunikacioni të shkaktuar nga një automjet i siguruar nga "Sigal Uniqa Group Austria" (në tekstin e mëtejme: "Sigal").
21. Në një datë të paspecifikuar, "Sigal" i kishte paraqitur një ofertë për kompensim dëmi parashtrueses së kërkesës, por kjo e fundit e kishte refuzuar ofertën me arsyetimin se shuma e ofruar nuk ishte reale.
22. Më 19 janar 2015, parashtruesja e kërkesës paraqiti padi pranë Gjykatës Themelore, të cilën e precizoi pas ekspertizës së marrë më 7 prill 2017, duke kërkuar (i) shumën e përgjithshme prej 12,500 euro, me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga dita e shkaktimit të dëmit e deri në pagesën definitive, në emër të kompensimit të dëmit material dhe jomaterial, si dhe (ii) shumën e përgjithshme prej 1.113 euro në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore.
23. Më 12 qershor 2017, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [C. nr. 47/2015], duke u bazuar në dispozitat përkatëse të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve të vitit 1978 dhe Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, miratoi pjesërisht kërkesëpadinë e parashtrueses së kërkesës, duke detyruar "Sigal" që t'i paguajë parashtrueses së kërkesës shumën prej 5, 454.30 euro në emër të dëmit material dhe jomaterial, me kamatë vjetore si për mjetet e deponuara mbi një vit në bankat private pa destinim të caktuar, nga 9 nëntori 2012 e deri në pagesën përfundimtare.

24. Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit të saj arsyetoi përcaktimin e kompensimit të dëmit material dhe jomaterial, duke u bazuar në nenin 154 [Bazat e përgjegjësisë], 155 [Dëmi], 158 [Ekzistimi i fajësisë], 178 [Përgjegjësia në rast aksidenti të shkaktuar nga automjetet në lëvizje], 185 [Kompensimi i Dëmit Material], 189 [Vëllimit i Kompensimit të Dëmit Material - Dëmi i thjeshtë dhe përfitimi i munguar], dhe 190 [Kompensimi i plotë] të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve të vitit 1978, si dhe përcaktimin e kamatës duke u bazuar në nenin 186 [Kur rrjedh për pagesë detyrimi i kompensimit] dhe 277 [Kamatëvonesa - Kur ka debitim] të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve të vitit 1978 duke konsideruar si moment të fillimit të llogaritjes së kamatës në rastin konkret datën e shkaktimit të dëmit.
25. Kundër Aktgjykimit të lartcekur, brenda afatit ligjor, “Sigal” në cilësinë e të paditurit paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozimin që Aktgjykimi [C. nr. 47/2015] i Gjykatës Themelore të priset dhe rasti të kthehet në rigjykim.
26. Parashtruesja e kërkesës nuk kishte paraqitur përgjigje në ankesë në Gjykatën e Apelit.
27. Më 11 gusht 2020, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac. nr. 1667/19] refuzoi ankesën e “Sigal” dhe vërtetoi Aktgjykimin [C. nr. 47/2015] e Gjykatës Themelore me arsyetimin se *“aktgjykimi i atakuar nuk i është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragraf 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së”*.
28. Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac. nr. 1667/19] arsyetoi se *“gjykata e shkallës së parë drejtë ka aplikuar të drejtën materiale sa i përket përgjegjësisë objektive të të paditurës, bazës për dëmin material dhe kamatës duke iu referuar dispozitave nga neni 154, 155, 158, 178, 158, 18 dhe 190 të LMD-së, e lidhur me nenin 323 të LPK-së”*.
29. Kundër Aktgjykimit të lartcekur, brenda afatit ligjor, “Sigal” parashtrroi revizion në Gjykatën Supreme për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të ndryshohen aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta lidhur me lartësinë e dëmit jomaterial për shëmtimin trupor dhe kamatën.
30. Parashtruesja e kërkesës nuk kishte paraqitur përgjigje në revizion.
31. Më 1 dhjetor 2020, në Mbledhjen e Përgjithshme të saj, Gjykata Supreme nxori mendim juridik për kamatën (Lidhur me ligjin e aplikueshëm, lartësinë dhe periudhën e llogaritjes), përmes të cilit ka shprehur qëndrimin e saj për unifikimin e praktikës gjyqësore përkitazi me ligjin e aplikueshëm, lartësinë dhe periudhën e llogaritjes në lidhje me kërkesat për kamatën.
32. Më 10 mars 2022, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev. nr. 51/21] aprovoi pjesërisht si të bazuar revizionin e “Sigal” dhe ndryshoi Aktgjykimin [Ac. nr. 1667/19] e Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimin [C. nr. 47/2015] e Gjykatës Themelore në pjesën e dispozitivit lidhur me lartësinë e dëmit jomaterial për shkak të shëmtimit trupor dhe kamatën, duke vendosur si në vijim:

*“-DETYROHET e paditura që paditëses Elire Krasniqi nga fshati Nagavc, Komuna e Gjakovës, në emër të kompensimit të dëmit jomaterial për shkak të*

*shëmtimit trupor t'i paguaj shumën prej 1,500 €, ndërsa pjesa tjetër e kërkesës për këtë formë të dëmit përtej shumës së gjykuar REFUZHET SI E PABAZUAR.*

*–DETYROHET e paditura që paditëses Elire Krasniqi nga fshati Nagavc, Komuna e Gjakovës t'ia paguaj kamatën të cilën e paguajnë bankat afariste në Kosovë sikur për mjetet e deponuara pa destinim të caktuar, për një vit, duke filluar nga data e marrjes së aktgjykimit të shkallës së parë 12.06.2017 e deri në pagesën definitive”.*

33. Në kontekst të kësaj të fundit, Gjykata Supreme, ndër të tjera, arsyetoi se (i) Gjykata Themelore dhe ajo e Apelit drejtë kanë vërtetuar gjendjen faktike por (ii) gabimisht kanë zbatuar të drejtën materiale gjatë përcaktimit të kompensimit të dëmit jomaterial dhe kamatës, respektivisht dispozitat përkatëse të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve të vitit 1978, si dhe (iii) në përcaktimin e kompensimit të dëmit jomaterial aplikoi nenin 200 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve të vitit 1978, ndërsa (iv) në përcaktimin e kamatës aplikoi nenin 277 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve të vitit 1978, duke përjashtuar kështu aplikueshmërinë e bazës ligjore të zbatuar nga Gjykata Themelore dhe ajo e Apelit.

*Në lidhje me procedurën përmbaremore*

34. Më 14 janar 2021, Zyra Përmbaremore e Përmbareuesit Privat duke vepruar sipas propozimit të parashtrueses së kërkesës në cilësinë e kreditores, lëshoi Urdhrin përmbaremore [P. nr. 01/2021], përmes të cilit ka lejuar përmbaremin e kompensimit të dëmit, ashtu siç është vërtetuar nga dy aktgjykimet e sipërpermbardura.
35. Kundër Urdhrit përmbaremore [P. nr. 01/2021], prapësim kishte paraqitur “Sigal” në cilësinë e debitorit, në Gjykatën Themelore në Prishtinë duke kërkuar përveç tjerash edhe shtyrjen e përmbaremit deri në vendosjen nga ana e Gjykatës Supreme lidhur me revizionin e paraqitur.
36. Më 28 prill 2022, Gjykata Themelore në Prishtinë, përmes Aktvendimit [PPP. nr. 20S/2021], e refuzoi si të pabazuar prapësimin e “Sigal” kundër Urdhrit përmbaremore [P. nr. 01/2021], duke vlerësuar se nuk janë përmbushur kushtet ligjore për anulimin e tij.
37. Në lidhje me Urdhrin përmbaremore, Gjykata nuk disponon informata të tjera e as parashtruesja e kërkesës nuk ka deponuar ndonjë informatë shtesë.

**Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

38. Parashtruesja e kërkesës pretendon se Aktgjykimi [Rev. nr. 51/21] i Gjykatës Supreme i 10 marsit 2022 është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të saj të garantuara me nenet 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së. Parashtruesja e kërkesës në thelb pretendon shkelje të së drejtës në vendim të arsyetuar gjyqësor, si rezultat i ndryshimit të vlerës së kompensimit të dëmit jomaterial dhe kamatës nga Gjykata Supreme pa “*asnjë justifikim të bazuar*”.
39. Përkitazi me pretendimet që ndërlidhen me mungesën e vendimit të arsyetuar gjyqësor, parashtruesja e kërkesës thekson se Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit të kontestuar ka ndryshuar vlerën e kompensimit të dëmit jomaterial në disfavor të saj pa bazë ligjore dhe në mënyrë arbitrare.
40. Në këtë kontekst, parashtruesja e kërkesës thekson se, “*Gjykata Supreme e ka ulur jashtëzakonisht shumë shumën e kompensimit, pa asnjë provë apo argument tjetër*

*nga ato që kanë shqyrtuar dhe analizuar gjykata e shkallës së parë dhe të dytë dhe pa asnjë justifikim të bazuar”.*

41. Parashtruesja e kërkesës tutje thekson se *“nëse Gjykata Supreme do ta kthente lëndën në rivendosje, do të krijonte mundësinë që Gjykata Themelore të rivendoste provat dhe argumentet, të cilat janë objekt i të provuarit në procedurë. Por, me këtë Aktgjykim, Gjykata Supreme ka cenuar të drejtën për gjykim të drejtë e të paanshëm, sepse nuk ka lënë mundësi tjetër të realizimit të mbrojtjes gjyqësore të të drejtave”.*
42. Përfundimisht, parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjykata që (i) kërkesën e saj ta shpallë të pranueshme; dhe (ii) të konstatojë që Aktgjykimi i kontestuar, përkatësisht Aktgjykimi [Rev. nr. 51/21] i 10 marsit 2022 i Gjykatës Supreme, është nxjerrë në kundërshtim me nenin 31 dhe 54 të Kushtetutës, duke e shpallur të njëjtin të pavlefshëm dhe duke e kthyer çështjen në rivendosje.
43. Gjithashtu, parashtruesja e kërkesës kërkon mos zbulim të identitetit duke theksuar se *“nuk ka ndonjë arsye të veçantë”.*

## **Dispozitat përkatëse kushtetuese dhe ligjore**

### **Kushtetuta e Republikës së Kosovës**

#### **Neni 31**

#### **[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]**

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
  2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
- [...]

#### **Neni 54**

#### **[Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]**

*Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.*

## **Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut**

#### **Neni 6**

#### **(E drejta për një proces të rregullt)**

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga

*gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.  
[...]*

## **Ligji Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore**

### **Neni 184 [Pa titull]**

*Zbatimi i gabueshëm i së drejtës materiale ekziston kur gjykata nuk e ka zbatuar dispozitën e së drejtës materiale që është dashur ta zbatojë, apo kur dispozitën e tillë nuk e ka zbatuar në mënyrë të drejtë.*

### **Neni 224 [Pa titull]**

*224.1 Në qoftë se gjykata e revizionit konstaton se e drejta materiale është zbatuar gabimisht, me aktgjykim e aprovon revizionin e paraqitur dhe e ndryshon aktgjykimin e goditur.*

*224.2 Po që se gjykata e revizionit konstaton se për shkak të zbatimit të gabueshëm të së drejtës materiale, apo për shkak të shkeljeve të rregullave procedurale, gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht dhe se për këtë arsye nuk ekzistojnë kushtet për ndryshimin e aktgjykimit të goditur, atëherë ajo me aktvendim e aprovon revizionin dhe e anulon pjesërisht apo tërësisht aktgjykimin e shkallës së parë dhe të dytë, apo vetëm aktgjykimin e shkallës së dytë, dhe çështjen ia dërgon për rigjykim gjyqtarëve të njëjtë apo të tjerë të gjykatës të shkallës së parë apo të dytë.*

## **Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve i 30 marsit 1978**

### **Neni 154 Prezumimi i kauzalitetit**

*Dëmi i shkaktuar lidhur me sendin e rrezikshëm, përkatësisht me veprimtarinë e rrezikshme konsiderohet se rrjedh nga ky send, përkatësisht nga kjo veprimtari, përveç nëse provohet se ato nuk kanë qenë shkak i dëmit.*

### **Neni 155 Kush përgjigjet për dëmin**

*Për dëmin nga sendi i rrezikshëm përgjigjet zotëruesi i saj, kurse për dëmin nga veprimtaria e rrezikshme përgjigjet personi që merret me të.*

### **Neni 158 Lirimi nga përgjegjësia**

*(1) Zotëruesi lirohet nga përgjegjësia në rast se provohet se dëmi rrjedh nga ndonjë shkak që ka ndodhur jashtë sendit dhe efekti i të cilit nuk ka mundur të parashihet, të mënjanohet ose të evitohet.*

*(2) Zotëruesi i sendit lirohet nga përgjegjësia edhe në rast se provohet se dëmi është shkaktuar vetëm nga veprimi i palës së dëmtuar ose i personit të tretë gjë të cilën ai nuk ka mundur të parashihet dhe pasojat e të cilit nuk ka mundur t'i shmangë ose t'i mënjanojë.*

(3) Zotëruesi lirohet nga përgjegjësia pjesërisht në rast se pala e dëmtuar pjesërisht ka kontribuar në shkaktimin e dëmit.

(4) Në rast se në shkaktimin e dëmit ka kontribuar pjesërisht personi i tretë, ky person i përgjigjet palës së dëmtuar solidarisht bashkë me zotëruesin e sendit.

(5) Personi që e ndihmon zotëruesin në përdorimin e sendit nuk konsiderohet si person i tretë.

### **Neni 185**

#### **Rivendosja e gjendjes së mëparshme dhe kompensimi në të holla**

(1) Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e ekzistuar para se të shkaktohej dëmi.

(2) Në qoftë se rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk e mënjanon plotësisht dëmin, personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të japë kompensim në të holla.

(3) Kur rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk është e mundshme apo kur gjykata konsideron se nuk është e domosdoshme që ta bëjë këtë personi përgjegjës, gjykata do të caktojë që ai t'ia paguajë dëmtuesit shumën përkatëse në të holla për efekt të kompensimit të dëmit.

(4) Gjykata do t'i gjykojë dëmtuesit kompensimin në të holla kur ai e kërkon këtë me përjashtim kur rrethanat e rastit konkret justifikojnë rivendosjen e gjendjes së mëparshme.

(...)

### **Neni 186**

#### **Kur rrjedh për pagesë detyrimi i kompensimit**

Detyrimi i kompensimit të dëmit konsiderohet se rrjedh për pagesë që nga momenti i shkaktimit të dëmit.

### **Neni 189**

#### **Dëmi i thjeshtë dhe përfitimi i munguar**

(1) I dëmtuari ka të drejtë si për kompensimin e dëmit të thjeshtë ashtu edhe për kompensimin e fitimit të munguar.

(2) Shuma e dëmit të thjeshtë caktohet sipas çmimeve në kohën e nxjerrjes së vendimit gjyqësor me përjashtim të rastit kur ligji urdhëron diçka tjetër.

(3) Gjatë vlerësimit të shumës së përfitimit të munguar merret në konsiderim fitimi ka mundur të pritej në mënyrë të bazuar sipas procesit të rregullt të sendeve ose sipas rrethanave të veçanta ndërsa realizimi i të cilave është penguar nga veprimi i dëmtuesit ose nga ometimi.

(4) Kur sendi është asgjësuar ose është dëmtuar për shkak të veprës penale të kryer me dashje gjykata mund të caktojë shumën e kompensimit sipas vlerës që ka pasur sendi për të dëmtuarin.

(...)

### **Neni 190**

#### **Kompensimi i plotë**

Gjykata, duke marrë parasysh edhe rrethanat që janë paraqitur pas shkaktimit të dëmit, do të caktojë kompensimin në shumën e nevojshme për të sjellë gjendjen materiale të të dëmtuarit në gjendjen në të cilën do të kishte qenë po të mos kishte ndodhur veprimi ose lëshimi i dëmshëm.



## **Neni 200** **Kompensimi në të holla**

*(1) Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore, për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të jetës, të prishjes, të shkeljes së nderit ose të lirisë, të vdekjes së personit të afërm si dhe për frikën gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit për frikën dhe zgjatja e tyre justifikon këtë, do të gjykojë kompensim të drejtë në të holla, pavarësisht nga kompensimi i dëmit material dhe nga mungesa e dëmit material.*

*(2) Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jomaterial si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjykata do të ketë parasysht për rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe të qëllimit të cilit shërben ky kompensim e gjithashtu edhe për faktin se mos t' u shkojë përshtat synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror.*

## **III.KAMATËVONESA** **Kur ka debitim** **Neni 277**

*(1) Debitori i cili vonohet në përmbushjen e detyrimit monetar, ka borxh, përpos kryegjësë, edhe shkallën e kamatës, e cila në vend të përmbushjes paguhet në deponime të kursimeve të afatizuara pa destinime të caktuara mbi një vit.*

*(2) Kamatëvonesën për detyrimin monetar që del nga kontrata në ekonomi, e përcakton Këshilli Ekzekutiv Federativ.*

*(3) Në qoftë se shkalla e kamatës kontraktuese është më e lartë se shkalla e kamatëvonesës, ajo vazhdon të rrjedhë edhe pas vonesës së debitorit.*

**Mendim Juridik për Kamatën (Lidhur me ligjin e aplikueshëm, lartësinë dhe periudhën e llogaritjes), i miratuar në mbledhjen e përgjithshme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, më 1 dhjetor 2020**

### **PJESA E TRETË**

#### **Periudha e pagesës së kamatës**

*XIV. Pavarësisht se kur është lindur marrëdhënia e detyrimeve për kërkesat që i referohen dëmit material (dëmi i zakonshëm apo fitimi i munguar), kamata fillon që të rrjedh nga data e parashtrimit të kërkesës së kreditorit për kompensim (e pranuar nga debitorit) dhe në rast të mos parashtrimit të kërkesës nga ana e kreditorit për kompensim. Atëherë kamata fillon që të rrjedh nga data e parashtrimit të padisë e deri në pagesën e plotë.*

*Nëse pala e dëmtuar e ka mënjeluar vetë dëmin para se të jepet vendimi i gjykatës, kamatëvonesa fillon nga dita e mënjanimit të dëmit, përkatësisht= nga dita që janë bërë shpenzimet për mënjanimin e tij, (kjo vlen për rastet kur dëmi është mënjeluar apo shpenzimet janë bërë para se të jetë ngritur padia, përndryshe kamata fillon nga data e parashtrimit të padisë).*

*XV. Pavarësisht se kur ka lindur marrëdhënia e detyrimeve për kërkesat që i referohen dëmit jomaterial, kamata fillon të rrjedh nga data e marrjes së aktgjykimit në gjykatën e shkallës së parë e deri në pagesën e plotë”.*

## Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

44. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.
45. Në këtë drejtim, Gjykata fillimisht iu referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

Neni 113

*"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

[...]

*7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

46. Gjykata më tej iu referohet kriterëve të pranueshmërisë, siç specifikohen në nenet 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47  
[Kërkesa individuale]

*"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*

*2. Individë mund të ngrenë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."*

Neni 48  
[Saktësimi i kërkesës]

*"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë."*

Neni 49  
[Afatet]

*"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [ .. ]."*

47. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata fillimisht thekson se parashtruesja e kërkesës është palë e autorizuar, që konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [Rev. nr. 51/21] e Gjykatës Supreme, të cilin e ka pranuar më 23 shtator 2022 dhe e ka parashtruar brenda afatit pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Gjithashtu, parashtruesja e kërkesës i ka qartësuar të drejtat dhe liritë kushtetuese, që ajo pretendon se i janë shkelur.
48. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 34 (Kriteret e pranueshmërisë) të

Rregullores së punës. Rregulli 34 (2) i Rregullores së punës përcakton kushtet në bazë të të cilave Gjykata mund të shqyrtojë një kërkesë, duke përfshirë edhe kushtin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Konkretisht, rregulli 34 (2) parasheh:

*“Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, kur parashtruesi/ja nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij/saj”.*

49. Rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpall një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës (shih rastin [KI04/21](#), parashtrues *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 majit 2021, paragrafi 26, shih gjithashtu rastin [KI175/20](#), parashtrues *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri, i 27 prillit 2021, paragrafi 37).
50. Bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNJ-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave, si “*pretendime qartazi të pabazuara*”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “*të shkallës së katërt*”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*”; (iii) pretendime “*të pambështetura apo të paarsyetuara*”, atëherë kur plotësohet njëri nga dy nënkriteret, në vijim: a) kur parashtruesi/ja i/e kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit qartazi duket shkelja e Kushtetutës dhe KEDNJ-së (shih, rastin e GjEDNJ-së [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), nr. 4241/03, vendimi i 31 majit 2005; shih gjithashtu [Baillard kundër Francës](#), nr. 6032/04, vendimi i 25 shtatorit 2008); dhe b) kur parashtruesi/ja i/e kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë prova materiale, me të cilat do t’i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë atë ta bëjë këtë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t’ia paraqes Gjykatës dokumentet nga dosja e një të burgosuri për të cilin bëhet fjalë) ose nëse Gjykata vet nuk vendos ndryshe (shih rastin e Gjykatës [KI166/20](#), parashtrues, *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 janarit 2021, paragrafi 43; dhe në fund, (iv) pretendime “*konfuzë dhe të paqarta*” shih rastet e GjEDNJ-së, [Kemmache kundër Francës](#), nr. 17621/91, Aktgjykimi i 24 nëntorit 1994, kategoria (i), [Juta Mentzen kundër Lituanisë](#), nr. 71074/01, vendimi i 7 dhjetorit 2004, kategoria (ii) dhe [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), Aplikimi nr. 4241/03, kategoria (iii) shih gjithashtu rastet [KI40/20](#), parashtrues *Sadik Gashi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 20 janarit 2021; [KI163/18](#), parashtrues *Kujtim Lleshi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 24 qershorit 2020; [KI21/21](#), parashtrues, *Asllan Meka*, Aktvendim për papranueshmëri, i 28 prillit 2021, [KI107/21](#), parashtrues *Ramiz Hoti*, Aktvendim për papranueshmëri, i 21 tetorit 2021).
51. Gjykata fillimisht do të rikujtojë thelbin e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtrueses së kërkesës, duke sqaruar se rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me një aksident që kishte ndodhur në nëntor të vitit 2012, i cili ishte shkaktuar nga një automjet i siguruar në “Sigal”, në të cilin aksident,



parashtruesja e kërkesës kishte pësuar lëndime fizike. Përgjegjësia për aksidentin kishte rënë mbi automjetin i cili ishte i siguruar në “Sigal”. Duke qenë që parashtruesja e kërkesës kishte refuzuar ofertën e “Sigal” për kompensim dëmi, ajo paraqiti padi pranë Gjykatës Themelore duke kërkuar 12,500 euro në emër të kompensimit të dëmit. Gjykata Themelore, duke u bazuar në Ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimeve të vitit 1978, i kishte dhënë të drejtë parashtrueses së kërkesës duke ia aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë dhe duke e detyruar “Sigal” që t’i paguajë parashtrueses së kërkesës shumën prej 5, 454.30 euro në emër të kompensimit të dëmit. Gjykata e Apelit kishte konfirmuar vendimin e Gjykatës Themelore lidhur me detyrimin e “Sigal” për kompensimin përkatës. Pas ankimit nga “Sigal”, Gjykata Supreme përfundimisht kishte konfirmuar të drejtën e parashtrueses së kërkesës në kompensimin përkatës, por kishte ndryshuar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit lidhur me lartësinë e dëmit jomaterial, dhe kamatën. Gjykata Supreme kishte përcaktuar që “Sigal” t’i paguaj parashtrueses së kërkesës shumën prej 1,500 euro në emër të kompensimit të dëmit jomaterial dhe ndryshimin e kamatës duke u bazuar në nenin 200 dhe 277 të LMD-së, me arsyetimin qendrorë se Gjykata Themelore dhe ajo e Apelit gabimisht kishin zbatuar të drejtën materiale gjatë vendosjes së rastit të parashtrueses së kërkesës. Këtë konstatim të Gjykatës Supreme, përkitazi me arsyetimin e ndryshimit të kompensimit të dëmit jomaterial dhe kamatës, parashtruesja e kërkesës e konteston para Gjykatës, duke pretenduar shkelje të nenit 31 dhe 54 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së.

52. Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës në thelb pretendon mungesë të vendimit të arsyetuar gjyqësor, duke theksuar, ndër të tjera dhe siç është sqaruar më lart, se Aktgjykimi i kontestuar ka ndryshuar Aktgjykimin [C. nr. 47/2015] e 12 qershorit 2019 të Gjykatës Themelore lidhur me vlerën e kompensimit të dëmit jomaterial dhe kamatën pa mbështetje në një bazë ligjore apo në ndonjë provë/fakt/argument tjetër nga ato që kanë shqyrtuar dhe analizuar tashmë gjykatat e instancës më të ultë. Më saktësisht, sipas parashtrueses së kërkesës, Aktgjykimi i Gjykatës Themelore dhe ai i Gjykatës së Apelit kanë pësuar ndryshime *“pa asnjë justifikim të bazuar”* nga ana e Gjykatës Supreme, dhe se duke mos e kthyer rastin në rivendosje *“Gjykata Supreme i’a ka cenuar paditëses gjykimin e drejtë dhe të paanshëm”*.
53. Këto kategori pretendimesh, e që në thelb ndërlidhen me mungesën e një vendimi të arsyetuar gjyqësor, Gjykata do t’i shqyrtoj duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
54. Rrjedhimisht, dhe në vijim, në mënyrë që të konstatojë nëse Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme është në përputhshmëri me garancitë e përcaktuara përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së përkitazi me vendimin e arsyetuar gjyqësor, Gjykata fillimisht do të rikujtojë parimet e përgjithshme të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës në këtë kontekst, dhe më pas do të aplikojë të njëjtat në rrethanat e rastit konkret.

*Parimet e përgjithshme lidhur me të drejtën për një vendim të arsyetuar*

55. Përkitazi me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor të garantuar përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së, Gjykata fillimisht thekson se ajo tashmë ka një praktikë të konsoliduar gjyqësore. Kjo praktikë është ndërtuar duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, përfshirë, por duke mos u kufizuar në rastet [Hadjianastassiou kundër Greqisë](#), Aktgjykim i 16 dhjetorit 1992; [Van de Hurk kundër Holandës](#), Aktgjykim i 19 prillit 1994; [Hiro Balani kundër Spanjës](#), Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994; [Higgins dhe të tjerët kundër Francës](#), Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998;



Garcia Ruiz kundër Spanjës, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; Hirvisaari kundër Finlandës, Aktgjykim i 27 shtatorit 2001; Suominen kundër Finlandës, Aktgjykim i 1 korrikut 2003; Buzescu kundër Rumanisë, Aktgjykim i 24 majit 2005; Pronina kundër Ukrainës, Aktgjykim i 18 korrikut 2006; dhe Tatishvili kundër Rusisë, Aktgjykimi i 22 shkurtit 2007. Për më tepër, parimet themelore sa i përket të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor janë elaboruar po ashtu në rastet e kësaj Gjykate, duke përfshirë, por pa u kufizuar në KI22/16, me parashtrues Naser Husaj, Aktgjykim i 9 qershorit 2017; KI97/16, me parashtrues "IKK Classic", Aktgjykim i 9 janarit 2018; KI143/16, me parashtrues Muharrem Blaku dhe të tjerët, Aktvendim për papranueshmëri i 13 qershorit 2018; KI24/17, me parashtrues Bedri Salihu, Aktgjykim i 27 majit 2019; KI35/18, me parashtrues "Bayerische Versicherungsverband", Aktgjykim i 11 dhjetorit 2019 dhe KI227/19, me parashtrues N.T. "Spahia Petrol", Aktgjykim i 31 dhjetorit 2020.

56. Në parim, garancitë e mishëruara në nenin 6, paragrafin 1 të KEDNJ-së, përfshijnë edhe detyrimin e gjykatave që të paraqesin arsyetim të mjaftueshëm për vendimet e tyre (shih rastin e GJEDNJ-së, H. kundër Belgjikës, nr. 8950/80, Aktgjykim i 30 nëntorit 1987, paragrafi 53). Vendimi i arsyetuar gjyqësor u tregon palëve se rasti i tyre është shqyrtuar me të vërtetë.
57. Përkundër faktit që gjykata e brendshme ka një liri të caktuar të vlerësimit lidhur me përzgjedhjen e argumenteve dhe vendosjes për pranueshmërinë e dëshmive, ajo është e detyruar të justifikojë veprimet e saj duke arsyetuar të gjitha vendimet e saj (shih, rastet e GJEDNJ-së: Suominen kundër Finlandës, nr. 37801/97, Aktgjykim i 24 korrikut 2003, paragrafi 36; si dhe rastin Carmel Saliba kundër Maltës, nr. 24221/13, Aktgjykim i 24 prillit 2017, paragrafi 73).
58. Gjykata më e ulët ose autoriteti shtetëror, nga ana tjetër, duhet të japin arsye dhe arsyeime të tilla të cilat do t'iu mundësojnë palëve të shfrytëzojnë në mënyrë efektive çdo të drejtë ekzistuese të ankesës (shih, rastin e GJEDNJ-së Hirvisaari kundër Finlandës, nr. 49684/99, Aktgjykim i 25 dhjetorit 2001, paragrafi 30).
59. Neni 6, paragrafi 1, i KEDNJ-së i detyron gjykatat të japin arsye për vendimet e tyre, por kjo nuk do të thotë se kërkohet përgjigje e detajuar lidhur me secilin argument (shih, rastet e GJEDNJ-së, Van de Hurk kundër Holandës, nr. 16034/90, Aktgjykim i 19 prillit 1994, paragrafi 61; Garcia Ruiz kundër Spanjës, nr. 30544/96, Aktgjykim i 29 janarit 1999, paragrafi 26; Perez kundër Francës, nr. 47287/99, Aktgjykim i 12 shkurtit 2004, paragrafi 81).
60. Nga natyra e vendimit që merr Gjykata varet nëse gjykata është e detyruar ta arsyetojë atë, dhe kjo mund të vendoset vetëm në dritën e rrethanave të rastit në fjalë: është e nevojshme të merren parasysh, ndër të tjera, llojet e ndryshme të parashtresave që një palë mund t'ia paraqesë gjykatës, si dhe dallimet që ekzistojnë midis sistemeve juridike të vendeve në lidhje me dispozitat ligjore, rregullat zakonore, pozicionet juridike dhe paraqitjen dhe hartimin e aktgjykimeve (shih, rastet e GJEDNJ Ruiz Toria kundër Spanjës, nr. 18390/91, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 29; Hiro Balani kundër Spanjës, nr. 18064/91, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 27).
61. Megjithatë, nëse parashtresa e një pale është vendimtare për rezultatin e procedurës, ajo kërkon që t'i përgjigjet në mënyrë specifike dhe pa vonesë (shih, rastet e GJEDNJ-së, Ruiz Toria kundër Spanjës, cituar më lart, paragrafi 30; Aktgjykimi Hiro Balani kundër Spanjës, cituar më lart, paragrafi 28).
62. Prandaj, gjykatat e brendshme janë të obliguara që:



- (a) të shqyrtojnë argumentet kryesore të palëve (shih, rastet [Buzescu kundër Rumanisë](#), nr. 61302/00, Aktgjykim i 24 gushtit 2005, paragrafi 67; [Donadze kundër Gjeorgisë](#), nr. 74644/01, Aktgjykim i 7 qershorit 2006, paragrafi 35);
- (b) të shqyrtohen me shumë rigorozitet dhe kujdes të veçantë kërkesat në lidhje me të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë, KEDNJ dhe protokollet e saj (shih, rastet e GJEDNJ-së: [Fabris kundër Francës](#), cituar më lart, paragrafi 72; [Wagner dhe JMWL kundër Luksemburgut](#), nr. 76240/01, Aktgjykim i 28 qershorit 2007, paragrafi 96).
63. Neni 6, paragrafi 1, nuk kërkon që gjykatat vendore të japin arsyetim më të detajuar kur ato thjesht zbatojnë një dispozitë të caktuar ligjore lidhur me bazën ligjore për refuzimin e ankesës sepse ajo ankesë nuk ka perspektivë për sukses (shih, rastet e GJEDNJ-së, [Burg dhe të tjerët kundër Francës](#), nr. 34763/02; Vendim i 28 janarit 2003; [Gorou kundër Greqisë](#) (nr. 2), nr. 12686/03, Vendim i 20 marsit 2009, paragrafi 41).
64. Në mënyrë të ngjashme, në një rast ku bëhet fjalë për një kërkesë që të lejohet parashtrimi i ankesës, që është një parakusht për procedurën para një gjykate më të lartë, si dhe për një vendim të mundshëm, neni 6, paragrafi 1, nuk mund të interpretohet në atë kuptim që të urdhërojë një arsyetim të detajuar të vendimit për refuzimin e kërkesës për parashtrimin e ankesës (shih, rastet e GJEDNJ-së, [Kukkonen kundër Finlandës](#) (nr. 2), nr. 47628/06, Aktgjykim i 13 prillit 2009,) paragrafi 24; [Bufferne kundër Francës](#), nr. 54367/00, Vendimi i 26 shkurtit 2002).
65. Përveç kësaj, kur refuzon një ankesë, gjykatat e apelit (në shkallën e dytë), në parim, thjesht mund të pranojë arsyetimin e vendimit të dhënë nga gjykata më e ulët (shih rastin e GJEDNJ-së, [García Ruiz kundër Spanjës](#), cituar më lart, paragrafi 26; shih, në kundërshtim me këtë, [Tatishvili kundër Rusisë](#), nr. 1509/02, Aktgjykim i 9 korrikut 2007), paragrafi 62). Megjithatë, koncepti i procesit të rregullt nënkupton që gjykata vendase që ka dhënë një shpjegim të ngushtë për vendimet e saj, qoftë duke përsëritur arsyetimet e dhëna më parë nga një gjykatë më e ulët ose në ndonjë mënyrë tjetër, në fakt merrej me çështje të rëndësishme brenda juridiksionit të saj, që do të thotë se nuk i pranoi thjesht dhe pa përpjekje shtesë konkluzionet e arritura nga gjykata më e ulët (shih rastin [Helle kundër Finlandës](#), nr. (157/1996/776/977), Aktgjykim i 19 dhjetorit 1997, paragrafi 60). Kjo kërkesë është aq më e rëndësishme nëse pala në kontest nuk ka pasur mundësi t'i paraqesë argumentet e saj gojarisht në procedurën para gjykatës vendase.
66. Megjithatë, gjykatat e apelit (në shkallën e dytë) të cilat kanë juridiksion për të hedhur poshtë ankesat e pabazuara dhe për të zgjidhur çështjet faktike dhe juridike në procedurën kontestimore, janë të obliguara të arsyetojnë se përse refuzuan të vendosin për ankesën (shih rastin e GJEDNJ-së, [Hansen kundër Norvegjisë](#), nr. 15319/09, Aktgjykim i 2 janarit 2015, paragrafët 77–83).
67. Përveç kësaj, GJEDNJ nuk përcaktoi se ishte shkelur e drejta në një rast në të cilin nuk është dhënë një sqarim specifik në lidhje me një pohim që i referohej një aspekti të parëndësishëm të rastit, përkatësisht mungesës së nënshkrimit dhe vulës, që është një gabim i një natyre më shumë formale sesa materiale dhe ai gabim u korrigjua menjëherë (shih rastin e GJEDNJ-së, [Mugoša kundër Malit të Zi](#), nr. 76522/12, Aktgjykim i 21 shtatorit 2016, paragrafi 63).

*Zbatimi i parimeve të përgjithshme në rrethanat e rastit konkret*



68. Gjykata rithekson se nuk është detyrë e saj që t'i zëvendësojë gjykatat e rregullta, që janë në pozitë më të mirë për t'i vlerësuar provat në dispozicionin e tyre, t'i konstatojnë faktet dhe interpretojnë të drejtën vendore (shih, për shembull, rastin e GJEDNJ-së, [Khamidov kundër Ruisisë](#), nr. 72118/01, Aktgjykim i 15 nëntorit 2007, paragrafi 170). Gjykata thekson se kur bëhet fjalë për konstatimin e fakteve dhe interpretimin e ligjit, është e “*ndjeshme*” për natyrën subsidiare të rolit të saj dhe se duhet të jetë e kujdesshme në marrjen e rolit të gjykatës së faktit, veçse kur një gjë e tillë është bërë e pashmangshme nga rrethanat e rastit (shih, për shembull, rastin e GJEDNJ-së, [Bărbulescu kundër Rumanisë](#), nr. 61496/08, Aktgjykim i 5 shtatorit 2017, paragrafi 129).
69. Gjykata thekson se në praktikën e saj gjyqësore në shumë raste ka konstatuar se çështjet e faktit dhe çështjet e interpretimit dhe zbatimit të ligjit janë brenda fushëveprimit të gjykatave të rregullta dhe të autoriteteve të tjera publike, në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës dhe si të tilla janë çështje të ligjshmërisë, përveç dhe përderisa, çështje të tilla rezultojnë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut ose krijojnë një situatë antikushtetuese (shih, mes tjerash, Gjykata Kushtetuese rasti nr. [KI33/16](#), parashtruese *Minire Zeka*, Aktgjykim i 4 gushtit 2018, paragrafi 91). Pavarësisht nga hapësira e vlerësimit të gjykatave të rregullta, vendimi përfundimtar lidhur me respektim të kriterëve të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së ngelet tek Gjykata Kushtetuese (shih dispozitat e neneve 4 paragrafi 6 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit] dhe 112 paragrafi 1 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës; dhe po ashtu, shih, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ-së, [Konstantin Markin kundër Ruisisë](#), nr. 30078/06, Aktgjykim i 22 marsit 2012, paragrafi 126).
70. Në aplikimin e parimeve të përgjithshme të shtjelluara më lart, në rrethanat e rastit konkret, dhe në mënyrë që të vlerësohet nëse Aktgjykimi i kontestuar është nxjerrë në përputhje me garancitë kushtetuese për një vendim të arsyetuar gjyqësor, Gjykata rikujton që në nxjerrjen e Aktgjykimit të kontestuar të saj, Gjykata Supreme kishte ndryshuar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore i cili ishte vërtetuar nga Gjykata e Apelit, përkitazi me kamatën dhe kompensimin e dëmit jomaterial duke e zvogëluar vlerën e tij në disfavor të parashtrueses së kërkesës dhe duke u bazuar në nenin 200 dhe 277 të LMD-së, me arsyetimin qendrorë se Gjykata Themelore dhe ajo e Apelit gabimisht kishin aplikuar të drejtën materiale gjatë vendosjes së rastit të parashtrueses së kërkesës.
71. Prandaj, duke pasur parasysh pretendimin kryesor ankimor të parashtrueses së kërkesës, Gjykata konsideron se duhet të analizohet nëse Gjykata Supreme, ka dhënë arsye të qarta dhe të mjaftueshme mbi të cilat e ka mbështetur vendimin e saj për ndryshimin e aktgjyqësive të instancave më të ulëta, lidhur me kompensimin e dëmit jomaterial dhe kamatën.
72. Gjykata, në vijim, rikujton arsyetimin e Gjykatës Supreme në Aktgjykimin [Rev. nr. 51/21], ku përkitazi me kompensimin e dëmit dhe kamatën, theksohet si në vijim:

*“Lidhur me pjesën e ndryshuar të aktgjyqësive të atakuara sa i përket dëmit jomaterial për shëmtimin trupor, Gjykata Supreme duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare dhe sipas pretendimeve në revizion për zbatimin e së drejtës materiale, ka bërë ndryshimin e aktgjyqësimit në kuptim të nenit 224.1 të LPK-së, sepse ka gjetur se nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, gjendja faktike është vërtetuar drejt dhe plotësisht, por sipas kësaj gjendje faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, është zbatuar gabimisht e drejta materiale.*”

Gjendja faktike për dëmin jomaterial për shëmtimin trupor, e për të cilat është vendosur si në pikën I, të dispozitivit të këtij aktgjykimi është konstatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë sepse gjykata e shkallës së parë në bazë të mendimit të ekspertëve mjekësorë nga lëmia e ortopedisë dhe psikiatrisë ka vërtetuar se paditësja si pasojë e aksidentit ka pësuar shëmtim trupor të shkallës së ulët, për shkak të cikatriksit në regjionin e ballit në gjatësi 3 cm, që paraqet pjesë e cila është vazhdimisht e ekspozuar dhe regjionin e gjurit të majtë në diametër 1xcm, prandaj duke vlerësuar se shuma e gjykuar nuk ishte në përputhje me qëllimin të cilit i shërben kompensimi, u vendos që për këtë kërkesë të ndryshohen aktgjykimet. Me këtë rast, Gjykata Supreme vlerëson se për çdo kërkesë lidhur me dëmin jomaterial gjykata duhet të ketë në konsideratë rëndësinë e shkëljes së të mirës dhe qëllimi të cilit i shërben ky kompensim, duke u kujdesur që kompensimi t'i shkojë përshtati synimeve që synohen me kompensimin e dëmit jomaterial e që është satisfakcioni për të dëmtuarin”.

Mbi këtë bazë gjykata duke e pasur parasysh natyrën e lehtë të lëndimeve që ka pësuar paditësja, shkallën e ulët të shëmtimit trupor, si dhe rrethanat tjera si moshën e re të paditëses që nënkupton se ajo për një kohë të gjatë potencialisht do t'i vuajë pasojat e lëndimit, praktikën e mirë gjyqësore për këtë formë të dëmit, vendosi që kompensimi të jetë në lartësi prej 1,500 €, **e të cilat rrethana janë në pajtim të plotë me nenin 200 të LMD-së.** Për pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë për këto kategori të dëmit Gjykata Supreme vlerëson se shuma e gjykuar nuk është në harmoni me pasojat e krijuara dhe me qëllimin të cilit i shërben kompensimi”.

Aktgjykimi është ndryshuar edhe sa i përket kamatës sepse gjykata e shkallës së parë gabimisht kishte aplikuar të drejtën materiale, prandaj Gjykata Supreme **ka vendosur duke iu referuar nenit 277 të LMD-së, duke filluar nga data e marrjes së aktgjyimit të shkallës së parë 12.06.2017, e deri në pagesën definitive,** sepse paditësja për dëmin dhe lartësinë e tij ka rënë në dijeni në momentin kur gjykata e shkallës së parë ka vendosur dhe nga ai moment kërkesa e saj për kompensim dëmi është bërë e kërkueshme dhe konsiderohet se e paditura ka rënë në vonesë për përmbushjen e detyrimit”.

73. Gjykata rikujton se Gjykata Themelore përmes Aktgjyimit [C. nr. 47/2015], i konfirmuar nga Gjykata e Apelit përmes Aktgjyimit [Ac. nr. 1667/19], arsyetoi përcaktimin e kompensimit të dëmit material dhe jomaterial duke u bazuar në nenin 154 [Bazat e përgjegjësisë], 155 [Dëmi], 158 [Ekzistimi i fajësisë], 178 [Përgjegjësia në rast aksidenti të shkaktuar nga automjetet në lëvizje], 185 [Kompensimi i Dëmit Material], 189 [Vëllimit i Kompensimit të Dëmit Material - Dëmi i thjeshtë dhe përfitimi i munguar], 190 [Kompensimi i plotë] të LMD-së, si dhe përcaktimin e kamatës duke u bazuar në nenin 186 [Kur rrjedh për pagesë detyrimi i kompensimit], si dhe nenin 277 [Kamatëvonesa - Kur ka debitim] të LMD-së, duke konsideruar si moment të fillimit të llogaritjes së kamatës, datën e shkaktimit të dëmit.
74. Bazuar në arsyetimin e lartcekur të Gjykatës Supreme, Gjykata vëren se e njëjta, fillimisht (i) konstatoi se Gjykata Themelore dhe ajo e Apelit kanë aplikuar gabimisht të drejtën materiale, respektivisht dispozitat ligjore të LMD-së që përcaktojnë kompensimin e dëmit jomaterial; (ii) i ndryshoi aktgjykimet e tyre përkitazi me shumën e kompensimit të dëmit jomaterial duke iu referuar nenit 200 të LMD-së, si dhe (iii) ndryshoi kamatën duke u bazuar në nenin 277 të LMD-së, me arsyetimin se dispozitat e sipërcekura të LMD-së, janë të aplikueshme në rrethanat e rastit konkret lidhur me kompensimin e dëmit jomaterial dhe përcaktimin e kamatës, për dallim prej dispozitave tjera të aplikuara nga Gjykata Themelore dhe ajo e Apelit.



75. Bazuar në arsyetimin e lartcekur të Gjykatës Supreme, Gjykata vë theks në faktin se e njëjta ka konstatuar aplikimin e gabuar të të drejtës materiale nga Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [C. nr. 47/2015] dhe nga Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac. nr. 116/19], të cilat kishin aplikuar dispozitat e LMD-së, lidhur me kompensimin e dëmit jomaterial dhe kamatën, dhe për pasojë aplikoi dispozitat e tjera, respektivisht nenin 200 [Kompensimi në të holla] të LMD-së, përkitazi me kompensimin e dëmit jomaterial, si dhe ndryshoi kamatën duke aplikuar nenin 277 [Kamatëvonesa - Kur ka debitim] të LMD-së.
76. Më tej, Gjykata vëren se Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit të saj kishte ndryshuar kamatën me arsyetimin qendrorë se gabimisht ishte aplikuar e drejta materiale, duke përjashtuar aplikimin e nenit 186 të LMD-së, të zbatuar fillimisht nga Gjykata Themelore, dhe duke iu referuar nenit 277 [Kamatëvonesa - Kur ka debitim] të LMD-së, me arsyetimin se detyrimi i kompensimit të dëmit fillon të rrjedh nga *“data e marrjes së aktgjykimit të shkallës së parë 12.06.2017, e deri në pagesën definitive, sepse paditësja për dëmin dhe lartësinë e tij, ka ra në dijeni në momentin kur gjykata e shkallës së parë ka vendosur dhe nga ai moment kërkesa e saj për kompensim dëmi është bërë e kërkueshme dhe konsiderohet se e paditura ka ra në vonesë për përmbushjen e detyrimit”*.
77. Për më tepër, Gjykata gjen se vendimmarrja e Gjykatës Supreme, në rrethanat faktike dhe juridike të rastit konkret është në pajtueshmëri edhe me mendimin juridik të nxjerrë nga mbledhja e përgjithshme e Gjykatës Supreme, e 2 dhjetorit 2020.
78. Në këtë drejtim, Gjykata do t' i referohet pjesës relevante të Mendimit Juridik të 1 dhjetorit 2020 të Gjykatës Supreme, e cila më tej sqaron periudhën e pagesës së kamatës në kontekst të kompensimit të dëmit jomaterial edhe në pikat XIV dhe XV, respektivisht, si në vijim.

*“Pavarësisht se kur ka lindur marrëdhënia e detyrimeve për kërkesat që i referohen dëmit jomaterial, **kamata fillon të rrjedh nga data e marrjes së aktgjykimit në gjykatën e shkallës së parë e deri në pagesën e plotë”**.*

79. Siç është sqaruar më lart, arsyetimi thelbësor i Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, bazuar në të cilin, në rrethanat e rastit konkret, është ndryshuar Aktgjykimi i Gjykatës Themelore dhe i Gjykatës së Apelit përkitazi me kompensimin e dëmit jomaterial dhe kamatën është se *“aktgjykimet e instancave më të ulëta janë përfshirë në zbatim të gabuar të së drejtës materiale”*.
80. Në këtë aspekt, në ndryshimin e Aktgjykimit të Gjykatës Themelore dhe të Gjykatës së Apelit, Gjykata Supreme kishte sqaruar (i) se aplikimi i dispozitave ligjore të LMD-së nga Gjykata Themelore dhe ajo e Apelit përbën aplikim të gabuar të të drejtës materiale; (ii) dhe për pasojë aplikoi dispozitat e tjera, respektivisht nenin 200 [Kompensimi në të holla] të LMD-së, përkitazi me kompensimin e dëmit jomaterial, si dhe ndryshoi kamatën duke aplikuar nenin 277 [Kamatëvonesa - Kur ka debitim] të LMD-së.
81. Në mbështetje të kësaj, Gjykata vëren se Gjykata Supreme vendimmarrjen e saj lidhur me kompensimin e dëmit jomaterial dhe kamatën e kishte bazuar duke iu referuar dispozitave ligjore përkatëse të LMD-së, e që rezultojnë të jenë në pajtim edhe me Mendimin juridik të 1 dhjetorit 2020, duke i konsideruar si të zbatueshme në rrethanat e rastit konkret, për dallim prej dispozitave tjera të aplikuara nga Gjykata Themelore dhe ajo e Apelit.

82. Bazuar në si më lart, Gjykata konstaton se Aktgjykimi i kontestuar, përmban arsyetim logjik dhe sqaron me saktësi dhe referencë të qartë ligjore se përse në rastin e parashtrueses së kërkesës përkitazi me kompensimin e dëmit jomaterial dhe kamatën janë aplikuar dispozitat e lartcekura të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve të RSFJ-së, të vitit 1978 (shih, rastet e GJEDNJ-së [Ruiz Toria kundër Spanjës](#), cituar më lart, paragrafi 30; [Hiro Balani kundër Spanjës](#), cituar më lart, paragrafi 28).
83. Gjykata, gjithashtu vëren që, pas miratimit të pjesërishëm të kërkesëpadisë e parashtrueses së kërkesës nga Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [C. nr. 47/2015], të datës 12 qershor 2017, “Sigal” në cilësinë e të paditurit paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit. Me këtë rast, parashtruesja e kërkesës nuk kishte paraqitur përgjigje në ankesë në Gjykatën e Apelit. Gjithashtu Gjykata vëren që, pasi që Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac. nr. 1667/19], të datës 11 gusht 2020, refuzoi ankesën e “Sigal” dhe vërtetoi Aktgjykimin [C. nr. 47/2015] e Gjykatës Themelore dhe se kundër këtij Aktgjykimi “Sigal” parashtrroi revizion në Gjykatën Supreme ndërsa parashtruesja e kërkesës nuk kishte paraqitur përgjigje në revizion. Gjykata gjithashtu vëren se, Zyra Përmbartimore e Përmbartuesit Privat duke vepruar sipas propozimit të parashtrueses së kërkesës në cilësinë e kreditores lëshoi Urdhrin përmbartimor [P. nr. 01/2021], më 14 janar 2021, përmes të cilit ka lejuar përmbartimin e kompensimit të dëmit, ashtu siç është vërtetuar nga dy aktgjykimet e sipërpërmendura. Kundër Urdhrit përmbartimor [P. nr. 01/2021], prapësim ka paraqitur “Sigal” në cilësinë e debitorit në Gjykatën Themelore në Prishtinë duke kërkuar përveç tjerash edhe shtyrjen e përmbartimit deri në vendosjen nga ana e Gjykatës Supreme lidhur me revizionin e paraqitur. Më 28 prill 2022, Gjykata Themelore në Prishtinë, përmes Aktvendimit [PPP. nr. 205/2021], e refuzoi si të pabazuar prapësimin e “Sigal” kundër Urdhrit përmbartimor [P. nr. 01/2021], duke vlerësuar se nuk janë përmbushur kushtet ligjore për anulimin e tij. (Sqarim: në lidhje me Urdhrin përmbartimorë Gjykata nuk disponon informata të tjera e as parashtruesja e kërkesës nuk ka deponuar ndonjë informatë shtesë).
84. Bazuar në si më lartë, Gjykata thekson se parashtruesja e kërkesës ka pasur mundësi të përfitojë nga procedura kontradiktore dhe se ka pasur mundësi që në fazat e ndryshme të procedurës t’i paraqet pretendimet dhe provat të cilat i ka konsideruar si të rëndësishme për rastin e saj; ka pasur mundësinë për t’i kundërshtuar pretendimet dhe provat e paraqitura nga pala kundërshtare në mënyrë efektive; gjykatat e rregullta i kanë dëgjuar dhe shqyrtuar të gjitha pretendimet, e të cilat, shikuar objektivisht, kanë qenë të rëndësishme për zgjidhjen e lëndës; dhe se arsyet faktike dhe juridike për vendimin e kontestuar janë paraqitur në detaje, dhe për këtë arsye procedura, e marrë në tërësi, ishte e drejtë (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 21 janarit 1999, [García Ruiz kundër Spanjës](#), nr. 30544/96, paragrafët 29 dhe 30; shih gjithashtu rastin [KI22/19](#), parashtrues [Sabit Ilazi](#), aktvendim për papranueshmëri, i 7 qershorit 2019, paragrafi 42; si dhe rasti [KI128/18](#), i cituar më lart, paragrafi 58).
85. Si përmbledhje, lidhur me pretendimin për shkelje të së drejtës për një vendim të arsyetuar dhe të arsyeshëm gjyqësor, Gjykata konkludon se Gjykata Supreme: (i) ka dhënë bazën juridike dhe ka shpjeguar me qartësi se përse në rastin e parashtrueses të kërkesës zbatohen dispozitat përkatëse të LMD-së nën dritën e rrethanave faktike dhe juridike të rastit konkret (ii) Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme përmban lidhje logjike ndërmjet bazës juridike, arsyetimit dhe përfundimeve të nxjerra; (iii) si rrjedhojë logjike ndërmjet bazës juridike, arsyetimit dhe përfundimeve ka rezultuar se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme, [Rev. nr. 51/21] të 10 marsit 2022, e plotëson kushtin e një vendimi të arsyetuar dhe të arsyeshëm gjyqësor (shih rastet e GJEDNJ-së, [Buzescu kundër Rumanisë](#), nr. 61302/00, Aktgjykim i 24 gushtit 2005, paragrafi 67; [Donadze kundër Gjeorgisë](#), nr. 74644/01, Aktgjykim i 7 qershorit 2006, paragrafi 35).

86. Prandaj, Gjykata konstaton se parashtruesja e kërkesës nuk ka mbështetur me prova pretendimin e saj për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.
87. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se pretendimet e parashtrueses së kërkesës për shkelje të së drejtës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së janë (i) pretendime që i takojnë kategorisë së “*të pambështetura apo të paarsyetuara*” dhe si të tilla, këto pretendime të parashtrueses së kërkesës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës.
88. Për sa i përket pretendimit të parashtrueses së kërkesës për shkelje të nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, Gjykata vlerëson se ky pretendim nuk do t'i nënshtrohet vlerësimit kushtetues për shkak se nuk ngre ndonjë çështje të re që nuk është trajtuar më parë në kuadër të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së (shih, *mutatis mutandis*, rastet e Gjykatës nr. [KI65/15](#), parashtrues *Tatjana Davila, Ljubiša Marić, Zorica Kršenković, Zlatoj Jevtić*, Aktgjykim i 14 shtatorit 2016; dhe nr. [KI193/18](#), parashtrues *Agron Vula*, Aktgjykim i 22 prillit 2020).

### **Kërkesa për moszbulimin e identitetit**

89. Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës kishte kërkuar që identiteti i saj të mos zbulohet publikisht, duke theksuar se “*nuk ka ndonjë arsye të veçantë*”.
90. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton rregullin 24 (1) të Rregullores së punës, i cili përcakton se “*Kurdo përgjatë procedurës së shqyrtimit të një kërkesë individuale sipas paragrafit 7 të nenit 113 të Kushtetutës dhe deri në publikimin e vendimit përfundimtar, palët mund të kërkojnë që identiteti i tyre të mos zbulohet publikisht. Kërkesa duhet të jetë e arsyetuar*”.
91. Prandaj, Gjykata konstaton se parashtruesja e kërkesës nuk e ka arsyetuar kërkesën e saj për moszbulim të identitetit dhe rrjedhimisht hedhë poshtë kërkesën e parashtrueses për moszbulim të identitetit si të pabazuar.



## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, në nenet 20 dhe 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullat 24, 34 (2) dhe 48 (b) të Rregullores së punës, më 28 maj 2024 njëzëri

### VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TË REFUZOJË, kërkesën për mos zbulim të identitetit;
- III. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- IV. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- V. Ky aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit;

**Gjyqtarja raportuese**

Remzije Istrefi-Peci



**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Gresa Caka-Nimani